

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendeve vakante **Specialist** pranë Departamentit të Teknologjisë së Informacionit / Sektori Billing / CRM

SPECIALIST

Projektimi, zhvillimi dhe mirëmbajtja e moduleve të sistemit të faturimit (Billing), duke siguruar funksionalitet të lartë, integrim me sistemet e tjera të organizatës dhe përputhshmëri me rregulloret financiare dhe teknike.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Zhvillimi dhe mirëmbajtja e moduleve të reja në sistemin e billing sipas kërkesave të biznesit.
- Analizimi i kërkesave funksionale dhe përkthimi i tyre në specifikime teknike dhe kod.
- Zbatimi i ndryshimeve në logjikën e tarifimit, strukturave tarifore dhe menaxhimi i proceseve të ciklit të faturimit.
- Zhvillimi i API-ve për integrim me sisteme të tjera si: CRM, arkëtim, OSS, ERP, portale web/mobile etj.
- Përmirësimi i performancës dhe sigurisë së sistemit të billing në bashkëpunim me ekipin e infrastrukturës dhe sigurisë.
- Dokumentimi i zhvillimeve të realizuara dhe mbështetje gjatë testimeve (unit test, integration test, UAT).
- Zgjidhja e problemeve teknike dhe mbështetje për incidentet kritike që prekin procesin e faturimit.
- Pjesëmarrja në projekte të transformimit digjital dhe automatizimit të ciklit të të ardhurave (revenue cycle).
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet e kërkuara:

- Diplomë në Informatikë, Inxhinieri Kompjuterike, Teknologji Informacioni ose fusha të ngjashme.
- Të paktën 2-4 vite përvojë si zhvillues softueri, preferohet në sisteme billing ose ERP.
- Njohuri të avancuara në:

Gjuhë programimi: Java / C# / .NET / Python

Baza të të dhënave: SQL Server, Oracle, PostgreSQL

Web services: RESTful / SOAP

- Eksperiencë me framework-e moderne (Spring, .NET Core, Angular, React) është avantazh.
- Njohuri për ciklin e faturimit, tarifim dinamik, penalitete, zbritje dhe menaxhimin e klientëve.
- Eksperiencë me sistemet e kontrollit të versioneve si Git dhe mjedise të CI/CD (p.sh. Jenkins, Azure DevOps).

Aftësi të dëshirueshme:

- Aftësi për të punuar në projekte komplekse dhe në bashkëpunim ndërdepartamental.
- Qasje analitike dhe mendim kritik për zgjidhje teknike optimale.
- Dokumentim i mirë dhe komunikim efektiv me ekipet e analizës, QA dhe përdoruesit fundorë.
- Njohuri mbi standardet GDPR, ISO 27001, dhe sigurinë e të dhënave është përparësi.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.